

**Data 22 /07/2024**

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS -PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT:** “MBROJTJE DHE SISTEMIM ME PRITA MALORE I PËRROIT TË GOMSIQES” .

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):** Punë ndërtimi 45000000-7.

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 216,000,000 (Dyqind e gjashtëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor KESH sh.a., ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

*a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*

*b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;*

**Argumentimi:**

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1.Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**  
Bazuar sa më sipër.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

**2.2.1** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, për të vërtetuar dhe garantuar se Operatorët Ekonomik Pjesëmarrës kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Në nenin 77, pika 3 e LPP citohet ndër të tjera si më poshtë: 3. "Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: 1. "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 (tre) vitet e fundit financiare, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, i ndryshuar.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:**

**i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.**

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

### **2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

**- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:**

**a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

**b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:**

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Akt kolaudimi objekti;

**Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P - 1/A Punime gjërmimi në tokë.  
N.P - 9/D Punime dhe mbrojtje lumore  
N.P - 12/A Punime të inxhinierisë së mjedisit

#### PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

N.S - 18/B Punime topogjeodezike  
N.S - 20/A Punime gjeologo -inxhinierike

*Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.***

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose Europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve sipas preventivit dhe argumentojmë si më poshtë:

**N.P 1/A** - Punime gërmimi në tokë

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me gërmime në tokë për strukturat dhe gërmime për hapjen e themeleve të vendosjes së rrjetave me gabion sipas projektit të zbatimit.

**N.P 9/D** - Punime për mbrojtje lumore

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me ndërtime dhe mbrojtjen e rrjedhës lumore për sistemimin e prurjeve dhe garantimin për mos depozitimin e ngurta në liqenin e Vau të Dejës . Në këtë projekt zbatimi kemi të bëjmë me mbrojtjen dhe konsolidimin e strukturave anësore të përroit të Gomsiqes.

**N.P 12/A** - Punime të inxhinierisë së mjedisit

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime të veçanta të shpërndara në territor dhe vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme sipas projektit të zbatimit.

**N.S - 18/B** - Punime topogjeodezike

Në këtë projekt zbatimi janë parashikuar punime që lidhen me zbatimin e rievimeve topografike, punimeve topogjeodezike që lidhen konkretisht me rrjetat mbështetëse dhe me qëndrueshmërinë e terreneve sipas projektit të zbatimit .

**N.S - 20/A** - Punime gjeologo -inxhinierike

Në këtë projekt zbatimi përfshihen vlerësimit e prurjeve të ngurta, qëndrueshmëria e bazamenteve për ndërtimin e pritave malore në përroitin e Gomsiqes dhe sistemimi i rrjedhës së lumit në zona me qëndrueshmëri të ulet dhe me aktivitet të lartë erozional, dhe për këtë arsye është e nevojshme që të kemi një analizë gjeologjike dhe gjeologo- inxhinierike të vazhdueshme të vendit ku do të bëhen këto punime.

**2.3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licenca/leje të lëshuara nga QKB si më poshtë:

- Licencë kategoria III.2.B - Grumbullim, ruajtje/magazininim, rikuperim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 538, datë 26.05.2009, “Për Licencat dhe Lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregulime të tjera nënligjore të përbashkëta” e ndryshuar, Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Ligji nr. 10431, date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, “Për Lejet e Mjedisit”.

Licenca kategoria III.2.B - Grumbullim, ruajtje/magazinim, rikuperim dhe transportim i mbetjeve të llojeve të ndryshme, është kërkuar në përputhje me projekt preventivin e zbatimit dhe bazuar në raportin e vlerësimit të mjedisit hartuar nga projektuesi ku specifikohet qartë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet bazë të mbrojtjes së mjedisit dhe mënyra e menaxhimit të mbetjeve duke përfshirë proceset e grumbullimit, ruajtjes/magazinimit, rikuperimit dhe transportimin e mbetjeve të llojeve të ndryshme. Projekti për mbrojtjen dhe sistemimi e përroit të Gomsiqes është i lidhur me zvogëlimin e efekteve të grumbullimit të aluvioneve dhe mbetjeve të ngurta në liqenin e Vaut të Dejës, kryesisht në rrjedhën e poshtme të tij deri në shkarkimin në liqenin e Vaut të Dejës, si dhe përmirësimin e pritave ekzistuese të cilat e kanë kryer rolin dhe qëllimin e realizimit të tyre nga tejmbushja me prurjet e ngurta të sjellë nga lumi i Gomsiqes.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 124 (njëqind e njëzet e katër) punonjës për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024):

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024).

### **Argumentimi:**






Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Kërkesa Teknike se Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 124 (njëqind e njëzet e katër) punonjës është në përputhje me objektin e prokurimit, rëndësisë së veprës, afatit kohor, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës, shpërndarjen e objekteve dhe fronteve të punës si dhe përcaktimit të numrit të punonjësve të kryer nga projektuesi. Është e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e nevojshëm në rastin konkret të konsiderueshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për një periudhë të caktuar të zbatimit të punimeve numri i punonjësve duhet të jete minimalisht 124 (njëqind e njëzet e katër) punonjës.

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me lis pagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.

**2.3.5** Operatorët ekonomik duhet të ketë të punësuar të përfshirë në licensën e shoqërisë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024), stafi inxhinierik si më poshtë:

-  minimalisht 1(një) Inxhinier Hidroteknik,
-  minimalisht 1(një) Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknik,
-  minimalisht 1(një) Inxhinier Mjedisi,
-  minimalisht 1(një) Inxhinier Gjeodet,
-  minimalisht 1(një) Inxhinier Gjeolog,

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- CV,

### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë



personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për Stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të pasur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

**Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:**

Për sa i takon inxhinierit Hidroteknik është kërkuar referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, pasi duhet të bëjë gjithë punën e nevojshme për të ulur dhe kontrolluar nivelet e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore , presionin hidrostatik për të lejuar gjitha gërmimet dhe ndërtimin të behën ne kushte te thata. Puna duhet të përfshijë testimin, operimin, mirëmbajtjen, supervizimin, dehidratimin dhe zhvendosjen nga vendi i ndërtimit i sistemit te dehidratimit siç përshkruhet në specifikimet teknike. Dehidratimi duhet të përfshijë devijimin, koleksionimin dhe heqjen e gjithë sipërfaqeve ku depërton uji nga vendi i punës, sistemin e ujerave nëntokësorë dhe sipërfaqësore nga gropat e sapo hapura për te lejuar ndërtimin në grope/kanal të thatë.

Për sa i takon inxhinierit të ndërtimit me profil (gjeoteknik), është kërkuar pasi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të nëntokës sipas zërave të preventivit të punimeve. Ky inxhinier duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e bazamentit dhe shpateve ku do të vendosen pritave malore. Duhet të sigurojë qëndrueshmërinë statike dhe dinamike të pritave malore në raport me prurjet e ngurta (aluvione) dhe plotat e lumit në periudha me prurje të mëdha.

Për sa i takon Inxhinierit te Mjedisit referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, janë parashikuar punime të veçanta të shpërndara në territor dhe vlerësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme sipas projektit të zbatimit, si dhe garantojë depozitim të materialeve që dalin nga gërmimet në vend depozitimet e sigurta dhe që janë konform kushteve mjedisore dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Për sa i takon Inxhinierit gjeodet, është kërkuar pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të zbatimit të projektit duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet gjeodezike, kuotat dhe koordinatat për te gjitha punimet e zbatimit që janë parashikuar në preventivin e punimeve, të gjitha punimet e zbatimit të fushës gjeodezike, i rilevimit topografik të zonës së sistemit të rrjedhjes së poshtme të lumit të Gomsiqes etj.

Për sa i takon Inxhinierit gjeolog, i specializuar ne fushën e gjeologjisë inxhinerike ka për detyrë vlerësimin gjeologjik dhe gjeoteknik të bazamenteve të pritave malore, thellësinë e themeleve,

trashësinë e aluvioneve , granulometria e materialeve lumore, cilësinë e tyre në varësi të projektit . Të vlerësojë dhe studiojë zonën me qëndrueshmëri të ulët në shpatet e lumit dhe aktivitetin erozional dhe akumulues të lumit gjatë fazës së projekt zbatimit.

**2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024), stafin mbështetës si më poshtë:

- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeolog/ Gjeoteknik
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Gjeodet
- ✚ minimalisht 1 (një) Inxhinier Hidroteknik

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë

***Argumentimi:***

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit mbështetës inxhinierët e kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

***Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:***

Për sa i takon inxhinierit të Gjeolog/ Gjeoteknik, është kërkuar pasi është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit dhe të nëntokës sipas zërave të preventivit të punimeve. Ky inxhinier duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e bazamentit dhe shpateve ku do të vendosen pritat malore. Duhet të sigurojë qëndrueshmërinë statike dhe dinamike të pritave malore në raport me prurjet e ngurta (aluvione) dhe plotat e lumit në periudha me prurje të mëdha.

Për sa i takon Inxhinierit gjeodet, është kërkuar pasi inxhinieri gjeodet do të jetë pjesë aktive e procesit të zbatimit të projektit duke bërë të mundur matjet dhe rilevimet gjeodezike, kuotat dhe koordinatat për te gjitha punimet e zbatimit që janë parashikuar në preventivin e punimeve, të gjitha punimet e zbatimit të fushës gjeodezike, i rilevimit topografik të zonës së sistemimit të rrjedhjes së poshtme të lumit të Gomsiqes etj.

Për sa i takon inxhinierit Hidroteknik është kërkuar referuar projektit të zbatimit dhe preventivit të punimeve, pasi duhet të bejë gjithë punën e nevojshme për të ulur dhe kontrolluar nivelet e ujerave sipërfaqësore dhe nëntokësore , presionin hidrostatik për të lejuar gjitha gërmimet dhe ndërtimin të behën ne kushte te thata.

Puna duhet të përfshije testimin, operimin, mirëmbajtjen, supervizimin, dehidratimin dhe zhvendosjen nga vendi i ndërtimit i sistemit te dehidratimit siç përshkruhet në specifikimet teknike. Dehidratimi duhet të përfshijë devijimin, koleksionimin dhe heqjen e gjithë sipërfaqeve ku depërton uji nga vendi i punës, sistemimin e ujrave nëntokësorë dhe sipërfaqësore nga gropat e sapo hapura për te lejuar ndërtimin në grope/kanal të thatë.

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024) punonjës të kualifikuar si më poshtë:

- + minimalisht 2 (dy) teknik ndërtimi
- + minimalisht 1(një) teknik topograf,
- + minimalisht 3 (tre) hekurthyes,
- + minimalisht 3 (tre) saldator,
- + minimalisht 6 (gjashtë) karpentier,
- + minimalisht 3 (tre) mekanik.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit Teknik,
- Dëshmi kualifikimi profesional /certifikate/diplomë të lëshuar nga institucionet kompetente të licencuara sipas Ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”.




#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar Projektit të zbatimit si dhe Preventivit të Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi. Për sa i takon stafit të kërkuar në këtë kriter, janë kërkuar pasi janë të nevojshëm për realizimin e punimeve që do të kryhen duke marrë parasysh shtrirjen e madhe dhe të terrenit te zbatimit dhe relievin e vështirë ku do punohet.

Për shkak të natyrës specifike dhe vendit ku do të kryhen punimet, trajnimi i punonjësve dhe pajisja e tyre më dëshminë për kualifikimin të sigurimit teknik/ diplomë të lëshuar nga institucionet kompetente të licencuara sipas Ligjit 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional”, është në përputhje me proceset e punës që parashikohen dhe volumin e kontratës që prokurohet.

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024) punonjësit si më poshtë:

-  minimalisht 3 (tre) automakinist,
-  minimalisht 5 (pesë) eskavatorist,
-  minimalisht 4 (katër) shoferë kamionash

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Dëshmi e aftësive profesionale / leje drejtimi të lëshuar nga DPSHTRR, të cilat duhet të jenë të vlefshme.
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

#### **Argumentimi:**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Plotësimi i këtij kriteri dëshmon se operatori i ka kapacitetet dhe burimet njereëzore për të kryer punimet në kohë dhe me cilësinë e duhur, sipas projektit dhe specifikimeve teknike. Përsa kohë që referuar kapacitetit teknik, pika 2.3.15, është parashikuar disponueshmëria e kamioneve, fadromave, eskavatoreve, si dhe makinerive të tjera të kërkuara, ku drejtimi i tyre mund të kryhet vetëm nga punonjës të kualifikuar, kriteri është në përputhje dhe proporcion me natyrën, terrenin ku do zbatohen punimet dhe volumin e kontratës objekt prokurimi.

**2.3.9** Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë në stafin e tij dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën (Prill 2024 – Qershor 2024) minimalisht 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetin në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së**

**afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Çertifikatë kualifikimi

#### **Argumentimi:**

Për sa i takon punonjësit i pajisur me çertifikatë për “Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me Ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Operatorët ekonomikë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të kenë kualifikimet dhe dokumentet përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentet përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

**2.3.10** Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktoj me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt. Drejtuesi teknik duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, të jetë inxhinier ndërtimi.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë
- CV

## Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në ndërtim” e ndryshuar me ligjin nr.120/2020 “Per disa ndryshime dhe shtesa” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të përcaktojnë Drejtuesin Teknik që do jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt.

**2.3.11** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon minimalisht 1(një) mjek të përgjithshëm, bazuar në VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar.

**Shëmin:** Nëse OE nuk ka në stafin e tij mjek të përgjithshëm mund ta sigurojë atë me anë të kontratë me persona apo subjekte të specializuara për këtë shërbim.

**Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

- Kontratë pune të vlefshme,
- Diplomë,
- Licencën përkatëse për ushtrimin e profesionit

## Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë” i ndryshuar.

**2.3.12** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001: “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001: "Sistemi i menaxhimit të mjedisit";
- c) ISO 45001: “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”.

## Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

**2.3.13** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi/distributori të autorizuar ose marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, për artikullin **Gabion me rrjetë teli**.

*Autorizimi /marrëveshja duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se paraqitet autorizim distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit nëpërmjet një dokumenti zyrtar të vlefshëm (kontratë, certifikatë, deklaratë etj.*

**Argumentimi:**

Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesve ose distributorëve të autorizuar për artikullin Gabion me rrjetë teli, është një dokument i rëndësishëm, i cili rrit sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të rëndësisë së veçantë të gabioneve që do të përdoret në funksion të realizimit të zërave përkatës referuar preventivit të punimeve që parashikon projekti objekt kontrate.

**2.3.14** Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët teknik për artikullin Gabion me rrjetë teli, në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike të parashikuara.

*Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuar, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

**Argumentimi:**

Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri, referuar

edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të parashikuara në këtë projekt.

**2.3.15** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	Emri i mjetit	Njësi	Sasi	Statusi
1	Eskavator me zinxhirë dhe krahë të gjatë min 17m	Cope	1	Në pronësi ose me qera
2	Eskavator me zinxhire kovë 0.5m <sup>3</sup>	Cope	3	Në pronësi ose me qera
3	Eskavator me goma (mjet teknologjik)	Cope	2	Në pronësi ose me qera
4	Fadrome me goma (mjet teknologjik)	Cope	2	Në pronësi ose me qera
5	Cekic hidraulik	Cope	1	Në pronësi ose me qera
6	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 Ton.	Cope	2	Në pronësi ose me qera
7	Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimum 10-20 Ton.	Cope	3	Në pronësi ose me qera
8	Kamionçina 3.5 – 5 Ton	Cope	2	Në pronësi ose me qera
9	Terheqes + Rimorkiator per mjete te renda kapacitet min 25 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
10	Autovinc me kapacitet mbajtes mbi 7 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
11	Miniekskavator	Cope	1	Në pronësi ose me qera
12	Rrul me gunga kapacitet 10 – 13 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
13	Rrul gome – hekur min 18 Ton	Cope	1	Në pronësi ose me qera
14	Kulle per ndricim kantieri	Cope	1	Në pronësi ose me qera
15	Gjenerator mbi 100 KVA	Cope	2	Në pronësi ose me qera
16	Pomp Uji	Cope	3	Në pronësi ose me qera
17	Betoniere kantieri vetengarkuese me kapacitet jo më të vogël se 2m <sup>3</sup>	Cope	2	Në pronësi ose me qera
18	Autobetoniere	Cope	2	Në pronësi ose me qera
19	Autopompë betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Damper kantieri	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Kompresorë ajri	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22	Gjeneratorë saldimi	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23	GPS + Total station	Copë	1	Në pronësi ose me qera
24	Impiant Betoni	Cope	1	Në pronësi ose me qera



25	Set laboratorik për testimin e betonit, i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN 12390 – 3:, SSH EN 12350-2:, SSH EN 12504-2	Copë	1	Në pronësi, me qera, ose kontratë shërbimi.
----	---	------	---	---

**“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:**

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronësi/qira do të paraqiten këto dokumenta:

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; lejen e transportit që lëshohet nga njësia vendore;  
Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjetet e marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë, e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- c) Për mjetet që transportojnë mjete të rënda duhet të paraqitet certifikata përkatëse e lëshuar nga institucioni kompetent i transportit rrugor.  
-Makinëritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.  
-Për secilin mjet të deklaruar duhet të paraqiten edhe fotot përkatëse ku të jetë lehtësisht e dallueshme targa e mjetit.  
-Për zërin 25. Set laboratorik për testimin e betonit, i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standardeve SSH EN 12390 – 3:, SSH EN 12350-2:, SSH EN 12504-2:, Duhet të paraqitet dokumentacion që provon pronësinë, kontratë qeraje noteriale ose kontratë noteriale të shërbimit.

*Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

#### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

### **Argumentimi i specifikimeve teknike:**

Specifikimet teknike- referuar relacionit teknik për punimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me qëllimin e hartimit të këtij projekti, hartuar nga projektuesi.

*Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.*

*Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.*

### **Njësia e Prokurimit.**